



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)

Data: 28 Dhjetor 2018

## **NJOFTIM PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE**

Të nderuar,

Ju njoftojmë se Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë, me aktes marrëveshje i ka vazhduar marrëveshjet kontraktuale për mjekët amë, stomatologët amë, gjinekologët amë, specialistët privat, specialistët stomatolog privat dhe laboratoritë (LU1 dhe LU2) nga data 01.01.2019 deri më 30.06.2019, ndërsa aneks marrëveshjet me barnatoret i ka vazhduar deri më 31.12.2019.

Në takimin e realizuar mes Fondit dhe Odave përkatëse, palët ranë në ujdë se marrëveshja nuk do të ketë masa dënimi deri në momentin e përpilimit të akteve nënligjore të cilat do ta rregullojnë këtë materie. Për këtë arsye, përgjatë kësaj periudhe sa është në fuqi aneks marrëveshja, Fondi do të realizojë kontrolle mbi punën e institucioneve shëndetësore.

Në lidhje me këtë, do të formohet grup punues ku nga ana e Odave përkatëse do të propozohen mjek të cilët në bashkëpunim me shërbimet profesionale të Fondit do të punojnë për përpilimin e akteve nënligjore.

Fondi vazhdon të jetë konstruktiv dhe i hapur për bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve shëndetësore, gjithnjë duke patur në plan të parë interesin e të siguruarve dhe me qëllim përmirësimin e kualitetit sa i përket ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Me respekt,

FSSHIM